

Nr. prot. _____

Tiranë____/____/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “InfraKonsult” sh.p.k. me NIPT L21512022F me adresë: Rruga “Qemal Stafa”, P.25; Shk.2, Ap.4, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Redi Struga.

Procedura e prokurimit: REF-88393-02-25-2021, me objekt: **“Hartimi i Procedurave për Aeroportin e Kukësit përfshirë SID dhe STAR, bazuar në një studim paraprak që mbështet këtë procedure, validimi i procedurës nëpërmjet vlerësimit nga një palë e tretë, simulatori dhe fluturimi nga ajri. Përgatitja e hartave të procedurës dhe updatimi i haratave të aeroportit që do të publikohen”**, me fond limit 62 500 000 (gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë: 3 (tre) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.03.2020, ora 11:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nuk ka.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Ofertuesi i parë: Operatori Ekonomik “Air Communication” sh.p.k. me NIPT L32409042E

- Çmimi i ofertës: 59 375 000 (pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh

2.Ofertuesi i dytë: Operatori Ekonomik “InfraKonsult” sh.p.k. me NIPT L21512022F

- Çmimi i ofertës: 57 500 000 (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh

3.Ofertuesi i tretë: Operatori Ekonomik “Regional Air Suport” s.r.l. N.12020346

- Çmimi i ofertës: 53 372 235 (pesëdhjetë e tre milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh

Është skualifikuar Operatori Ekonomik "Regional Air Suport" s.r.l me N. 12020346 për arsye se:

a. Bazuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim, Kapaciteiti Teknik, pika 4, "*OE duhet të paraqiste vertetim të lëshuar nga Administrata Tatimore*"

Referuar dokumentacionit të paraqitur në tender nuk ka asnjë vërtetim të paraqitur nga administrata tatimore apo e sigurimeve shoqërore për punonjësit e tij. Operatori ka paraqitur një vetdeklarim të pagesave të sigurimeve shoqërore. Ky dokument është i papranueshëm dhe absolutisht i pavlefshëm për t'u vlerësuar. Për sa më sipër ky kriter kualifikues nuk plotësohet referuar dokumentacionit të paraqitur.

b. Gjithshtu duke mos patur një dokumentacin të lëshuar nga administrata tatimore ky operator ekonomik nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në Kapaciteiti Teknik, pika 5. Kjo për faktin se ngelemi vetëm në kuadër të vetdeklarimit dhe jo të provuar nga administrata shtetërore e vendit, ku ata janë të regjistruar si shoqëri tregtare. Për sa më sipër ky kriter kualifikues nuk plotësohet referuar dokumentacionit të paraqitur

c. Referuar Kapaciteiti Teknik pika 4, OE duhet të kishte: "*OE, duhet të jetë në zotërim të certifikatës ISO/IEC 27001:2013...*" referuar dokumentacionit të paraqitur nuk vërtetohet që kjo shoqëri në vendit e aktivitetit të saj ka këtë certifikim. Dokumentacioni i paraqitur, ku ka marrë një certifikim nga një Autoritet Shqiptar nuk mund të jetë i pranueshëm, kjo për faktin se Operatori është i regjistruar në regjistrat tregtar Rumun dhe nuk ka asnjë kontakt, të dhënë apo regjistrim në regjistrat tregtar Shqiptar, për pasojë trupa certifikuese nuk ka autoritet të certifikojë një subjekt që nuk është objekt i ligjit Shqiptar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomik "InfraKonsult" sh.p.k. me NIPT L21512022F me adresë: Rruga "Qemal Stafa", P.25; Shk.2, Ap.4, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Redi Struga, ka paraqitur ofertën me vlerë 57 500 000 (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh, e cila është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë ALBCONTROL SHA, me adresë në Aeroportin Nënë Tereza Rinas, pranë Zyrës së Prokurimeve, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [59 375 000 (pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.03.2021

Ankesa: Nuk ka

Për ALBCONTROL SHA

Mina Kusta
Drejtore i Përgjithshëm